

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. 5436 Prot

Tiranë, më 28.07.2020

Lënda: Dërgojmë aktet për emërimin e Drejtorit të BKH-së

Drejtuar : KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

TIRANË

Të nderuar,

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përfunduar procesin e përzgjedhjes së kandidaturës për pozicionin Drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit. Në zbatim të parashikimeve të nenit 33, pika 2, të ligjit Nr.95/2016 ju dërgojmë aktet e Komisionit të Përzgjedhjes :

1. Vendim – “Mbi përzgjedhjen e kandidatit fitues për pozicionin Drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit”.
2. Relacion – “Mbi procedurën e ndjekur për përzgjedhjen e kandidatit fitues për pozicionin Drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Duke vlerësuar rëndësinë e madhe që ka procesi i përzgjedhjes së Drejtorit të BKH-së; nevojën ekstreme për të filluar sa më shpejt nga puna me qëllim ngritjen e strukturës së BKH-së; faktin që neni 32, pika 2 e ligjit Nr.95/2016 kërkon që para emërimit kandidati për Drejtor duhet të ketë përfunduar programin e trajnimit; faktin që programi i trajnimit është planifikuar në bashkëpunim me misionin ICITAP të kryhet gjatë muajit gusht; do të rekomandoja që Këshilli i Lartë i Prokurorisë të realizonte procedurë e emërimit brenda muajit korrik 2020, duke u shprehur që vendimi hyn në fuqi, me 1 Shtator 2020, pas përfundimit të programit të trajnimit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

ARBEN KRAJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Komisioni i Përzgjedhjes së Drejtorit të BKH-së

V E N D I M

MBI PËRZGJEDHJEN E KANDIDATIT FITUES PËR POZICIONIN DREJTOR I BYROSË KOMBËTARE TË HETIMIT

Komisioni i Përzgjedhjes së Drejtorit të BKH-së, në vijim të procedurës së identifikimit të kandidatit më të mirë për pozicionin e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (SPAK), zhvilloi dy mbledhje, në datat 24.07.2020 dhe 27.07.2020, në prani dhe të Komisionit të Pavarur të Rishikimit, (i përbërë nga dy përfaqësues të Bashkimit Europian dhe dy përfaqësues të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri).

Gjatë këtyre mbledhjeve Komisioni shqyrtoi dokumentacionin e 4 (katër) kandidatëve që janë në garë për pozicionin e Drejtorit të BKH-së deri në këtë moment, konkretisht, zoti Artur Beu, zoti Ervin Hodaj, zoti Idajet Faskaj dhe zonja Aida Veizaj, dhe e vlerësoi këtë dokumentacion në raport me kriteret e parashikuara në nenin 34 të ligjit Nr.95/2026, (ku përcaktohen kriteret që duhet të plotësojë përpara emërimit Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit).

Në vijim Komisioni i Përzgjedhjes administroi dhe dokumentin “Opinion këshillues për organin përgjegjës për verifikimin e kushteve të sigurisë në bazë të nenit 6 të ligjit për Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar”, i paraqitur me shkrim me datë 27.07.2020 nga Komisioni i Pavarur të Rishikimit”.

Në përfundim, duke vlerësuar të gjithë dokumentacionin sa më sipër, bazuar në përcaktimet e neni 33/2 të ligjit Nr.95/2016, Komisioni i Përzgjedhjes

V E N D O S I :

1. T'i rekomandojë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, emërimin e znj. Aida Veizaj, në pozicionin e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, për një mandat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi.




2. Ky vendim, së bashku me një relacion ku shpjegohet procedura e ndjekur nga Komisioni i Përzgjedhjes për përzgjedhjen e kandidatës fituese, t'i dërgohen Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Vendimi i Komisionit të Përzgjedhjes të publikohet në faqen web të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Tiranë, në datë 27.07.2020.

KOMISIONI I PËRZGJEDHJES

Arben Kraja



Ened Nakuçi



Behar Dibra





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR**
Komisioni i Përzgjedhjes së Drejtorit të BKH-së

RELACION

**MBI PROCEDURËN E NDJEKUR PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATIT FITUES
PËR POZICIONIN DREJTOR I BYROSË KOMBËTARE TË HETIMIT**

Drejtuar : KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË


TIRANË

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme dhe fillimit të ushtrimit të funksioneve nga kjo prokurori me datën 19.12 2019, procesi i përzgjedhjes së kandidatit për pozicionin e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, ka qënë procesi më i rëndësishëm i organizuar në Prokurorinë e Posaçme, në drejtim të ngritjes së strukturës së Byrosë Kombëtare të Hetimit. I gjithë procesi është zhvilluar duke respektuar detyrimet e parashikuara në ligjin Nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (SPAK). Në vijim po ju paraqesim në mënyrë të detajuar gjithë procedurën e ndjekur për të realizuar këtë proces shumë të rëndësishëm.

Zgjedhja e Komisionit të Përzgjedhjes

Me datë 23.12.2019, bazuar në përcaktimet e nenit 33/2 të ligjit Nr.95/2016, u zhvillua mbledhja e gjithë prokurorëve të emëruar nga KLP-ja në Prokurorinë e Posaçme, me qëllim përzgjedhjen e Komisionit të Përzgjedhjes, i cili do të realizonte procedurën e përzgjedhjes së kandidatit që do i rekomandohej KLP-së për pozicionin e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit. U administrua paraprakisht nga KPL-ja vjetërsia në punë si prokuror që kishin të gjithë



prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, nga ku rezultoi se prokurori Behar Dibra kishte 21 vite vjetërsi si prokuror, ndërsa prokurorët Ened Nakuçi dhe Altin Dumani kishin të njëjtën datë emërimi dhe të njëjtën vjetërsi, (19 vite). Në vijim u hodh shorti ndërmjet dy prokurorëve me të njëjtën vjetërsi pune dhe nga shorti u përzgjedh prokurori Ened Nakuçi.

Në përfundim u zgjodh Komisioni i Përzgjedhjes i përbërë nga zoti Arben Kraja, me cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe zoti Behar Dibra dhe zoti Ened Nakuçi, në cilësinë e dy prokurorëve me më shumë vite eksperiencë pune si prokuror.

Zgjedhja e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës

Përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës, u krye me datë 27.01.2020 nga Prokuroria e Posaçme dhe Gjykatat e Posaçme në të njëjtën ditë duke u bazuar në përcaktimet e nenit 57 të ligjit Nr.95/2016, në praninë e Avokatit të Popullit. Përfaqësues të Prokurorisë së Posaçme u caktuan në bazë të shortit prokurorët Edvin Kondili dhe Behar Dibra, ndërsa përfaqësues i gjykatave të posaçme u caktua në bazë të shortit gjyqtari Dhimitër Lara.

Prokurori Behar Dibra paraqiti me datën 13.02.2020 dorëheqjen nga pozicioni i anëtarit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës për arsye se ishte i zgjedhur edhe në Komisionin e Përzgjedhjes dhe mbajtja e dy funksioneve përbënte konflikt interesi. Në këto kushte me datën 17.02.2020 u mbajt në prani të Avokatit të Popullit mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, në të cilin nga shorti i hedhur u përzgjedh prokurori Altin Dumani, si anëtar i tretë i Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës.

Pra përfundimisht Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës ishte i përbërë nga prokurori Edvin Kondili – Kryetar, prokurori Altin Dumani dhe gjyqtari Dhimitër Lara – anëtar.

Komisioni i Pavarur i Rishikimit

Ligji Nr.95/2016 parashikon në nenin 57/9 të tij, krijimin e Komisionit të Pavarur të Rishikimit, të përbërë nga ekspertë të drejtësisë penale të caktuar nga misionet e Bashkimit Europian dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amërikës në Shqipëri. Komisioni do të japë udhëzime dhe këshillime për themelimin dhe zhvillimit e Byrosë Kombëtare të Hetimit për një periudhë 2 vjeçare, duke nisur nga momenti i themelimit të saj.

Me datën 28.01.2020 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme i është drejtuar me një letër zyrtare ambasadorëve të BE-së dhe SHBA-së në Tiranë, duke kërkuar caktimin nga ana e tyre të ekspertëve në Komisionin e Pavarur të Rishikimit.

Ambasadori i BE-së në Tiranë, me letrën e datës 06.02.2020, konfirmoi si përfaqësues të Delegacionit të BE-së në Tiranë ekspertët: zonjën Mari-Ann Roos (gjyqtarë Apeli në Suedi) dhe zotin Carmine Pirozzoli (prokuror nga Italia).



Ambasadorja e SHBA-së në Tiranë, me letrën e datës 18.02.2020, konfirmoi si përfaqësues të Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë ekspertët : zonjën Michelle Lakomy (prokurore – OPDAT) dhe zotin Steven Schneider (ekspert policor – ICITAP).

Me letrën e datës 27.07.2020, Ambasadori i BE-së në Tiranë, konfirmoi zëvendësimin e ekspertit Carmine Pirozoli (mbaroj mandatin në Shqipëri) me zotin Carlo D’Achille (oficer policie nga Italia dhe Drejtues i misionit PAMECA V).

Miratimi i Rregullorës së veprimtarisë nga Komisioni i Përzgjedhjes

Komisioni i Përzgjedhjes, miratoi me datën 06.01.2020 dokumentin “Rregullore për procesin e përzgjedhjes së Drejtorit të BKH-së”. Sipas këtij akti procesi i përzgjedhjes do të realizohej në 6 faza :

1. Ekzaminimi paraprak i aplikimit;
2. Vizitë mjeksore dhe test për aftësitë fizike;
3. Ese me shkrim dhe test për arsyetimin logjik;
4. Testi poligrafit dhe intervistë në panel;
5. Verifikim i figurës dhe pasurisë;
6. Identifikimi i kandidatit fitues, trajnimi dhe emërimi.

Hapja e garës për pozoicionin e Drejtorit të BKH-së

Komisioni i Përzgjedhjes, në mbledhjen e datës 08.01.2020 vendosi që :

1. Procedura e njoftimit dhe aplikimit të zhvillohej online në faqen zyrtare të internetit www.spak.al , në pjesën që i takon BKH-së.
2. Për efekt komunikimi me kandidatët e mundshëm të hapej një adresë email : bkh.aplikim@spak.al
3. Njoftimi për fillimin e procedurës të publikohej me datë 10.01.2020 dhe dita e fundit e pranimit të aplikimeve të ishte data 30.01.2020.
4. Miratimin e listës dhe përmbajtjen e akteve që do publikohen online dhe do jenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes dhe konkretisht :
 - 4.1. Mesazh nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, 1 faqe.
 - 4.2. Njoftim për vend të lirë pune, 3 faqe.
 - 4.3. Formular aplikimi për Drejtor të BKH-së, 8 faqe.
 - 4.4. Testet e përzgjedhjes, 1 faqe.



Procedura e konkurimit dhe përzgjedhja e kandidatit fitues

Faza a I-rë.

Aplikimet për kandidatët e interesuar ishin të hapura nga data 10.01.2020 deri me datën 30.01.2020. Gjatë kësaj periudhe kandiduan 41 shtetas për pozicionin e Drejtorit të BKH –së. Në përfundim të procesit të aplikimit Komisioni i Përzgjedhjes, në mbledhjen e datës 01.02.2020, administroi të gjitha aplikimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët duke shqyrtuar 41 (dyzetënjë) aplikime (dosje) të dërguara nga kandidatët elektronikisht në adresën bkh.aplikim@spak.al, të cilat ishin edhe të protokolluara në Sekretarinë e Prokurorisë së Posaçme.

Lista e plotë e aplikantëve ishte si më poshtë:

1. Adriatik Ago
2. Agim Ismaili
3. Aida Veizaj
4. Ajas Gjeta
5. Arben Karkini
6. Ardian Çipa
7. Artan Pjetërnikaj
8. Artan Shkëmbi
9. Artur Beu
10. Atnan Shehu
11. Bardhi Koçi
12. Blerina Bajollari
13. Blerta Dervishi
14. Bujar Madani
15. Dritan Osmani
16. Edmond Kasmi
17. Eduart Merkaj
18. Endrit Hoxha
19. Enver Levani
20. Ervin Hodaj
21. Ervin Hoxha
22. Gentian Hilla
23. Gentjan Shehaj
24. Gjovalin Ulndreaj
25. Haris Ngjeqari
26. Ibrahim Disha
27. Idajet Faskaj
28. Krenar Ahmeti
29. Kristaq Dashi
30. Lindita Nushi
31. Mimoza Haxhihyseni
32. Pal Shkambi
33. Pëllumb Seferi
34. Petrit Imeraj
35. Rekela Ismaili
36. Sabri Hoxha
37. Saimir Shehri
38. Xhabir Zejnuni
39. Ylli Pjetërnikaj
40. Zef Preçi
41. Shpëtim Aga

Lidhur me kandidatin Shpëtim Aga, gabimisht emri i tij nuk u përfshi në listën e aplikantëve që u njoftuan në faqen e internetit të BKH-së, por kandidatura e tij u mor në shqyrtim nga Komisioni i Përzgjedhjes.

Komisioni i vlerësoi kandidatët në lidhje me plotësimin e kriterëve ligjore bazë të parashikuara në nenin 34 të Ligjit Nr.95/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve për Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” si më poshtë:



- Kandidati për Drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit mund të jetë personi që ka vetëm shtetësi shqiptare, që gëzon cilësi të larta profesionale dhe morale, dhe që plotëson këto kritere:
 - a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë të barasvlershme me “Master i shkencave”, ose arsimin e lartë policor;
 - b) ka eksperiencë pune si prokuror, punonjës i Policisë së Shtetit apo Policisë Gjyqësore ose hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit;
 - c) ka përvojë pune të paktën 5 vjet në çështje që kanë të bëjnë me veprat penale në fushën e korrupsionit, krimit të organizuar apo krimeve të rënda;
 - ç) nëse ka qenë apo është punonjës i Policisë së Shtetit, të ketë mbajtur për jo më pak se 3 vjet gradën “Komisar”, “Kryekomisar”, “Drejtues” apo “Drejtues i Parë”;
- Të ketë dërguar deklaratat për dhënien e pëlqimit të tij dhe të anëtarëve të afërt të familjes për heqjen e dorë nga privatësia (dhënien e pëlqimit për kontroll periodik të llogarive bankare dhe telekomunikimeve vetjake).

Komisioni pasi vlerësoi çdo kandidat në lidhje me plotësimin e kritereve të mësipërme dhe plotësoi një tabelë mbi plotësimin ose jo të kritereve nga kandidatët, vendosi që kandidatët e kualifikuar për të vazhduar më tej fazat e përzgjedhjes janë si më poshtë:

- | | |
|----------------------|----------------------|
| 1. Adriatik Ago | 11. Endri Hoxha |
| 2. Agim Ismaili | 12. Ervin Hodaj |
| 3. Aida Veizaj | 13. Gentian Hilla |
| 4. Ardian Çipa | 14. Gentjan Shehaj |
| 5. Artan Pjetërnikaj | 15. Idajet Faskaj |
| 6. Artan Shkëmbi | 16. Lindita Nushi |
| 7. Artur Beu | 17. Pëllumb Seferi |
| 8. Atnan Shehu | 18. Ylli Pjetërnikaj |
| 9. Blerina Bajollari | |
| 10. Eduart Merkaj | |

Faza e II-të.

Në mbledhjen e datës 03.02.2020, Komisioni i Përzgjedhjes përcaktoi procedurat dhe afatet për fazën e dytë të konkurimit. Faza e dytë e konkurimit përmban testin fizik dhe testin me shkrim.

1. Testi aftësive fizike, që do të zhvillohej me datën 6 Shkurt 2020, në orën 9.30 në vendndodhjen e zyrave të RENEAs, në Yzberisht, Tiranë. Para zhvillimit të testit fizik kandidatët duhet të njoftohen se gjatë kësaj faze do t’ju kërkohet që të kryejnë ushtrimet e mëposhtme:

- (a) 300-metër sprint;
- (b) palosje për një minutë;
- (c) pompa,
- (d) një vrap për 2.4 km.

2. Testi me shkrim, që do të zhvillohej me datën 10 Shkurt 2020, grupi i parë prej 9 kandidatësh në orën 9.30, dhe grupi i dytë prej 9 kandidatësh në orën 13.00, në Sallën e Testimeve “Infosoft”, Kati II, Pallati “Torre Drin”, Rr: “Abdi Toptani” Tiranë. Gjatë kësaj faze kandidatëve do t’ju kërkohet të kryejnë ushtrimet e mëposhtme:

(a) testi për arsyetimin logjik që përbëhet nga 30 pyetje (duhet të përfundohet për 45 minuta);

(b) test eseje me shkrim (një orë).

Testi i esesë do t’ju kërkojë të shkruajnë një ese mbi një temë që ka të bëjë me përpjekjet e Shqipërisë për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ata do të vlerësohen në lidhje me sa i janë përmbajtur pyetjes në përgjigjet e dhëna, qartësinë e argumentimit, formatimin dhe drejtëshkrimin.

Në përfundim të dy testeve të mësipërme Komisioni i Përzgjedhjes do bëjë vlerësimin e kandidatëve për rezultatet dhe do të përzgjedhë 6 (gjashtë) prej tyre për të vazhduar në fazën e tretë, që përmban testin e poligrafit, intervista me kandidatët dhe në vijim vetingu i tyre. Përsa më sipër Komisioni vendosi që të miratojë dhe dokumentat :

1. “Mesazh pozitiv për aplikantin”, i cili i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Rezultatet e testit fizik.
3. Pyetësor për gjendjen shëndetsore para testit fizik.
4. Testi i arsyetimit logjik (dy variante testi të ndryshme)
5. Eseja (dy variante të ndryshme)

Këto dokumente do t’u njoftohen të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë në momentin që do zhvillohet testimi përkatës. Përveç sa më sipër u miratuan dhe përgjigjet e dy testeve të arsyetimit logjik, të cilat administrohen vetëm nga Komisioni i Përzgjedhjes.

Në datë 14.02.2020, Komisioni i Përzgjedhjes së Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, zhvilloi mbledhjen e radhës me objekt : “vlerësimi të mëtejshëm të kandidatëve që do kalojnë në fazën e testimit të poligrafit dhe atë të intervistave. Mbledhja u zhvillua ne prani të përfaqësuesve të misionit ICITAP, dhe të Komisionit të Pavarur të Rishikimit.

Duke vlerësuar rezultatet e testit fizik, testit logjik, esesë dhe aftësitë profesionale dhe eksperiencën e mëparshme të kandidatëve në funksione drejtuese në Policinë e Shtetit në përfundim Komisioni i Përzgjedhjes vendosi të miratojë listën përfundimtare për kualifikim të kandidatëve për në fazat e mëtejshme si më poshtë vijojnë:



- 1 Ervin Hodaj
- 2 Idajet Faskaj
- 3 Artur Beu
- 4 Ylli Pjetërnikaj
- 5 Ardian Çipa
- 6 Gentjan Shehaj
- 7 Lindita Nushi
- 8 Aida Veizaj

Poligrafi dhe rezultatet e testit

Ligji Nr.95/2016 në nenin 34/2, germa (gj), parashikon detyrimin që kandidati për drejtor i BKH-së duhet të japë pëlqimin dhe t'i nënshtrohet testit të poligrafit. Informacioni në raportin e përgatitur nga specialisti i poligrafit mbahet në konsideratë gjatë procesit të përzgjedhjes.

Për të realizuar këtë detyrim ligjor me datën 10.02.2020 u nënshkrua një "Marrëveshje Bashkëpunimi" ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme.

Në vijim, në mbledhjen e datës 11.02.2020 Komisioni i Përzgjedhjes diskutoi në lidhje me përgatitjen e rregullores së zhvillimit të testit të poligrafit dhe akteve të tjera të nevojshme. U vlerësua se nga Komisioni janë marrë praktikat më të mira të zhvillimit të testit nga misioni i asistencës ICITAP, si dhe nga konsultat me ekspertët e Njësisë së Specializuar të Poligrafit, pranë Shërbimit për Çështjet e Brëndshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brëndshme, të cilët janë të licencuar përkryerjen e këtij testi dhe do ta kryejnë këtë test, bazuar në marrëveshjen e lidhur me datë 10.02.2020 ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe Shërbimit për Çështjet e Brëndshme dhe Ankesat. Përfundimisht Komisioni i Përzgjedhjes miratoi aktet si më poshtë vijon :

1. Formulari i dhënies së pëlqimit për ekzaminimin e poligrafit.
2. Lista e çështjeve dhe nënpyetjet e poligrafit.
3. Rregullore për ekzaminimet e poligrafit.

Me shkresën Nr. 1415 Prot., datë 14.02.2020, u dërguan pranë Shërbimit për Çështjet e Brendshme emrat dhe dokumentacioni i nevojshëm për 8 kandidatët e kualifikuar deri në atë moment me qëllim realizimin e testit të poligrafit.

Me shkresën Nr. 521/9 Prot., datë 24.02.2020 Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat solli raportet finale të ekzaminimit për 8 kandidatët, të mbyllura dhe vulosura në zarfa të veçantë për secilin kandidat.

Në lidhje më rezultatet e testit të poligrafit Komisioni i Përzgjedhjes, pasi mori dhe opinionin e Komisionit të Pavarur të Rishikimit, vendosi që të mos hapë asnjë zarf dhe ja delegoj



vlerësimin e rezultateve të testit të poligrafit Komisionit të Posaçëm për Verifikimin e Pasurisë dhe Figurës për ata kandidatë që do bëhej vetingu.

Intervista e kandidatëve

Në datë 25.02.2020, Komisioni i Përzgjedhjes për Drejtorin e BKH-së zhvilloi në praninë e Komisionit të Pavaruar të Rishikimit (Komisionit Ndërkombëtar), mbledhjen e radhës, lidhur me procedurën e organizimit të intervistave të kandidatëve të kualifikuar deri në këtë moment për këtë pozicion.

Në përfundim, Komisioni vendosi që intervistat do zhvillohen në datat 26 dhe 27 shkurt, 2020, në Sallën e Mbledhjeve të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Çdo kandidat do ketë një orë në dispozicion, për t'iu përgjigjur pyetjeve të anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes. I gjithë procesi do të monitorohet nga Komisioni i Pavaruar i Rishikimit (Komisioni Ndërkombëtar), sipas përcaktimeve të nenit 57, pika 9, e ligjit Nr.95/2016, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar". Intervistat do kryhen në rendin alfabetik si më poshtë:

Në datën 26.02.2020

1. **Aida Veizaj,** ora 10.00
2. **Ardian Çipa** ora 11.00
3. **Artur Beu** ora 12.00
4. **Ervin Hodaj** ora 13.00

Në datën 27.02.2020

1. **Gentjan Shehaj** ora 10.00
2. **Lindita Nushi** ora 11.00
3. **Idajet Faskaj** ora 12.00
4. **Ylli Pjetërnikaj** ora 13.00

Komisioni i Përzgjedhjes për Drejtorin e BKH-së, në datat 26 dhe 27 shkurt 2020, zhvilloi intervistat e strukturuar me 8 (tetë) kandidatët e përzgjedhur deri në këtë fazë, në praninë e Komisionit të Pavaruar të Rishikimit (Komision me përfaqësues nga misionet e BE-së dhe Qeverisë së SHBA-ve). Çdo kandidat u intervistua duke përdorur të njëjtën metodë intervistimi, të miratuar më parë nga Komisioni i Përzgjedhjes. Rezultatet e vlerësimit të intervistave iu shtuan rezultateve të mëparshme të kandidatëve.

Në përfundim, Komisioni i Përzgjedhjes përzgjodhi 4 (katër) kandidatët më të mirë deri në këtë moment, të cilët do t'i nënshtrohen fazës përfundimtare të verifikimit. Kandidatët e përzgjedhur ishin si më poshtë:

1. Aida Veizaj
2. Artur Beu
3. Ervin Hodaj
4. Idajet Faskaj

Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve.

Në vijim të procesit, 4 kandidatët e kualifikuar ju nënshtruan procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës, i përbërë nga prokurori Edvin Kondili – Kryetar dhe prokurori Altin Dumani e gjyqtari Dhimitër Lara – anëtar.

Drejtuesi i prokurorisë së Posaçme, i dërgoi zyrtarisht emrat e kandidatëve për verifikim, duke i shoqëruar me “deklaratën për pasurinë dhe interesat private”, “Deklaratën për llogaritë financiare”, “Deklaratën për Kontrollin e Figurës”, “Raport ekzaminimi poligrafi” (zarf të mbyllur), etj., për secilin nga 4 kandidatët e kualifikuar.

Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së kandidatëve, pasi ka kryer verifikimet e nevojshme, me datën 22.07.2020, i ka paraqitur Komisionit të Përzgjedhjes “Raportet e Verifikimit” për secilin nga 4 kandidatët në garë. Konkluzionet e këtyre raporteve janë :

1. Kandidati Ervin Hodaj, nuk plotëson kushtet e sigurisë të parashikuara në nenin 6, paragrafi i parë, germa “a”, të ligjit Nr.95/2016.
2. Kandidati Artur Beu, nuk plotëson kushtet e sigurisë të parashikuara në nenin 6, paragrafi i parë, germa “a”, të ligjit Nr.95/2016.
3. Kandidati Idajet Faskaj, nuk plotëson kushtet e sigurisë të parashikuara në nenin 6, paragrafi i parë, germa “a”, të ligjit Nr.95/2016.
4. Kandidatja Aida Veizaj, plotëson kushtin e sigurisë të parashikuar në nenin 6, paragrafi i parë, germa “a”, të Ligjit nr.95/2016.

Në zbatim të parashikimeve të nenit 34/2, gjerat “f” dhe “g” të Ligjit Nr.95/2016, ju kërkua Autoritetit për Informimin mbi Dokumentat e ish- Sigurimit të Shtetit që të verifikonte 4 kandidatët e përzgjedhur. Në përfundim të procesit të verifikimit Autoriteti për Informimin mbi Dokumentat e ish- Sigurimit të Shtetit konfirmoi se asnjëri prej kandidatëve nuk kishte pengesa ligjore në këtë drejtim.

Në zbatim të parashikimeve të nenit 34/2, germa “d” të Ligjit nr.95/2016, ju kërkua Prokurorit të Përgjithshëm që të bënte verifikimin e thelluar të Formularit të Vetedeklarimit për secilin prej 4 kandidatëve të kualifikuar. Në përfundim të procesit të verifikimit, Prokurori i Përgjithshëm konfirmoi se asnjëri nga kandidatët nuk ndodhet në kushtet e ndalimit që parashikon ligji nr.138/2015, për të ushtruar funksionin publik.




Përzgjedhja e kandidatit fitues

Komisioni i Përzgjedhjes zhvilloi dy mbledhje në datat 24.07.2020 dhe 27.07.2020, në prani dhe të Komisionit të Pavarur të Rishikimit, i përbërë nga dy përfaqësues të Bashkimit European dhe dy përfaqësues të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri.

Komisioni pasi shqyrtoi dokumentacion e katër kandidatëve që kishin ngelur në garë, konkretisht. Z. Artur Beu, z. Ervin Hodaj, z. Idajet Faskaj dhe znj. Aida Veizaj, në raport me kriteret e parashikuara në nenin 34 të ligjit nr.95/2016, që duhet të plotësojë Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, pasi administroi dhe “Opinionin këshillues të Komisionit të Pavarur të Rishikimit”, bazuar në përcaktimet e neni 33/2 të ligjit nr.95/2016, vendosi që t’i rekomandojë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, emërimin e znj.Aida Veizaj, në pozicionin Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, për një mandat pesëvjeçar.

KOMISIONI I PËRZGJEDHJES

Arben Kraja



Ened Nakuçi

Behar Dibra

